IKTK
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore

GJURMA MUJORE

Maj 2026

Inspektim në terren;
Kalaja e Stanit, Lushnje

Praktikë e studentëve në laboratorin e restaurimit

Verifikim në terren;
Xengë, Divjakë

Inspektim;
Kisha e Marmiroit, Vlorë

Prezantim,
Kalaja e Elbasanit

Vijojnë punimet restauruese në Kalanë e Borshit

Konservim,
Shpella e Spilesë në Himarë

Përfunduan gërmimet arkeologjike;
Parku Arkeologjik Amantia

Inspektim në rrënojat e termave romake,Belsh

Botimi nr. 05
IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Inspektim në terren; Kalaja e Stanit, Lushnje

Gjatë inspektimit në terren nga specialistët e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore , në kodrën e Golldares, në vendin e njohur si “Kalaja e Stanit”, u evidentuan rrënojat e një fortifikimi të periudhës së Antikitetit të Vonë. Pozicioni strategjik dhe gjurmët e strukturave të konstatuara dëshmojnë për vlera të rëndësishme historike dhe arkeologjike.

Ky evidentim pasuron të dhënat mbi trashëgiminë kulturore dhe nënvizon nevojën për studim e dokumentim të mëtejshëm të sitit.





IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.









IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Praktikë e studentëve në laboratorin e restaurimit

Studentët e vitit të tretë të Departamentit të Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore (FHF, UT) zhvilluan një sesion praktik në laboratorin e IKTK-së, ku u njohën me praktikat bashkëkohore të ndërhyrjeve në veprat e artit dhe objektet arkeologjike.

Gjatë vizitës, ata panë nga afër proceset e konservimit dhe restaurimit, teknikat bazë të ndërhyrjes, si dhe rëndësinë e dokumentimit profesional. Punimet në laborator përfshijnë trajtimin e pikturës murale, objekteve arkeologjike, ikonave dhe materialeve të tjera me vlera historike e artistike—duke krijuar një lidhje të drejtpërdrejtë mes teorisë dhe praktikës.







IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Verifikim në terren; Xengë, Divjakë

Gjatë verifikimeve në “Kodrën e Ullishtës”, e cila shtrihet në lindje të kishës së Shën Kollit, në fshatin Xengë të Bashkisë Divjakë, u konstatua prania e materialit arkeologjik, kryesisht material ndërtimor, fragmente tullash dhe tjegullash, si edhe fragmente enësh qeramike të përdorimit të përditshëm. Ky material dëshmon për gjurmë të rëndësishme të aktivitetit njerëzor në këtë zonë dhe sugjeron ekzistencën e një vendbanimi ose strukture arkeologjike, i cili meriton studim dhe dokumentim të mëtejshëm. Paraprakisht, gjetjet datojnë në një hark të gjerë kohor, nga shekulli IV p.e.s. deri në Mesjetën e Vonë, duke dëshmuar për një përdorim të gjatë dhe rëndësi të vazhdueshme të kësaj zone në periudha të ndryshme historike.

Këto gjetje arkeologjike i kontribuojnë zgjerimit të mëtejshëm të njohurive mbi potencialin arkeologjik të territorit të Divjakës dhe hedhin dritë mbi vazhdimësinë e jetës përgjatë epokave të ndryshme historike.



IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.















IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Inspektim; Kisha e Marmiroit, Vlorë

Specialistët e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK) zhvilluan një inspektim në Kishën e Marmiroit, monument kulture i kategorisë së I-rë, për vlerësimin e gjendjes së ruajtjes së objektit dhe përcaktimin e ndërhyrjeve konservuese e restauruese. Objekti, me vlera të rëndësishme historike e arkitekturore, karakterizohet nga muraturë me gurë të parregullt të kombinuar me fragmente tullash dhe tjegullash.

Nga inspektimi u evidentuan disa nevoja për ndërhyrje restauruese, të lidhura me pastrimin nga vegjetacioni , mirëmbajtjen e muraturave dhe sistemimin e zonës përreth, në funksion të ruajtjes së qëndrueshme të monumentit.



IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Prezantim, Kalaja e Elbasanit

Një vizion i ri për Kalanë e Elbasanit po merr formë. Arkitekti Emre Arolat dhe MVM Architecture prezantuan projektin e rivitalizimit të saj.
Projekti synon ta kthejë Kalanë në një destinacion të rëndësishëm kulturor dhe turistik, duke vlerësuar identitetin historik, pasurinë arkeologjike dhe rolin e saj në jetën e qytetit. Parashikohen ndërhyrje për përmirësimin e hapësirave publike, zhvillimin e potencialit turistik dhe rijetëzimin e zonës historike.

Pas prezantimit, projekti do të ndjekë procedurat institucionale deri në miratimin përfundimtar. Hartimi i tij financohet nga AADF, në bashkëpunim me IKTK, Bashkinë Elbasan, Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe FSHZH.







IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Vijojnë punimet restauruese në Kalanë e Borshit

Prej disa muajsh vijojnë punimet restauruese në Kalanë e Borshit, me synimin për të ruajtur monumentin dhe për të garantuar sigurinë e tij afatgjatë. Ndërhyrjet janë përqendruar në stabilizimin e masivit shkëmbor dhe të shpatit, përmirësimin e aksesit në kala, si edhe në konservimin dhe rijetëzimin e strukturave historike.
Një vëmendje e veçantë i është kushtuar restaurimit të xhamisë, ku po kryhen ndërhyrje në muraturë, përforcim i elementëve të dëmtuar dhe restaurim i pikturave murale, duke ruajtur autenticitetin dhe vlerat e saj historike.

Gjatë pastrimit të bimësisë dhe largimit të rrënojave janë evidentuar edhe elementë të rinj me interes të veçantë historik, duke pasuruar më tej njohuritë mbi këtë monument të rëndësishëm të trashëgimisë kulturore.









IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Konservim, Shpella e Spilesë në Himarë

Shpella e Spilesë në Himarë është një nga hapësirat më të veçanta të bregdetit shqiptar, ku natyra, historia dhe legjendat ndërthuren në një peizazh unik. Përmes një ndërhyrjeje të kujdesshme synohet mbrojtja dhe interpretimi i kësaj pasurie, duke krijuar kushte që vizitorët ta njohin dhe përjetojnë atë pa cenuar vlerat e saj natyrore dhe historike.
Projekti parashikon ndriçimin e pjesës së brendshme të shpellës, duke e bërë atë të dallueshme edhe gjatë natës, si dhe rikualifikimin e hapësirës përpara saj për ta kthyer në një zonë publike më funksionale dhe të integruar me vijën bregdetare.

Kjo ndërhyrje do të pasurojë ofertën turistike dhe kulturore të Himarës, duke lidhur trashëgiminë natyrore me atë kulturore. Projekti financohet nga Banka Botërore përmes Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në bashkëpunim me IKTK, me projektim nga CHwB Albania dhe monitorim nga DRTK Vlorë.





IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.











IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Përfunduan gërmimet arkeologjike; Parku Arkeologjik Amantia

Përfunduan gërmimet arkeologjike në Parkun Arkeologjik të Amantias, rreth 30 kilometra në juglindje të Vlorës, të cilat sollën zbulime të rëndësishme për njohjen e organizimit urbanistik dhe historisë së këtij qyteti antik. Gërmimet e zhvilluara nga DRTK Vlorë dhe IKTK, nxorën në dritë një godinë antike në zonën e agorasë, si edhe të dhëna të reja mbi fortifikimin e qytetit të poshtëm, duke dëshmuar vazhdimësinë e jetës dhe zhvillimit të Amantias nga shek. III p.Kr. deri në shek. VI m.Kr.

Kërkimet do të vijojnë edhe në vitet e ardhshme, së bashku me ndërhyrje restauruese që synojnë ruajtjen dhe promovimin e kësaj pasurie të çmuar të trashëgimisë sonë kulturore.



IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Inspektim në rrënojat e termave romake,Belsh

Specialistët e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore zhvilluan një inspektim në rrënojat e termave romake në Belsh, një strukturë me vlera të rëndësishme historike ku ruhen ende elementë të sistemit të hipokaustit dhe ambienteve të termës.
Gjatë verifikimit në terren u evidentuan problematika si degradimi i materialeve ndërtimore, dëmtime në tullat dhe strukturat mbajtëse, prania e vegjetacionit, si dhe ndikimi i ujërave sipërfaqësorë që rrezikojnë qëndrueshmërinë e sitit.

Ndërhyrjet e rekomanduara synojnë pastrimin e zonës, konsolidimin e mureve dhe dyshemeve, restaurimin e elementëve të dëmtuar dhe zbatimin e një sistemi drenazhi për menaxhimin e lagështisë, me qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen afatgjatë të këtij monumenti arkeologjik.









IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.